

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR 467 Rep.

NR 146 Kol

KONTRATE SHITBLERJE
(Kuota te shoqerise)

Ne Tirane, sot me daten 26 Shkurt 2007 (dymije e shtate), ndermjet Paleve te meposhtme u lidh , me vullnet te plote e te lire te tyre, kjo Kontrate Shitblerje - kuota te shoqerise , si me poshte:

SHITESIA :Znj. Ardita Prendi, e bija e Ndrec Prendi, e datlindjes 03.08.1977, e lindur ne Puke dhe banuese ne Tirane , shtetase shqiptare, madhore e me zotesine e plote per te vepruar, per identitetin e te cilit une noteri u sigurova nepermjet pasaportes personale Nr. Z1522440,

BLERESI: - Z. Ndrek Lleshi, i biri i Preng Lleshi, i datlindjes 04.04.1980,i lindur ne Puke dhe banues ne Tirane , shtetas shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar , per identitetin e te cilit une noteri u sigurova nepermjet pasaportes nr. Z0832094.

Personat e mesiperm , me vullnet te plote e te lire lidhen kete Kontrate Shitblerje (kuota) me permbajtje si vijon :


1. H Y R J E :

Me Vendimin Nr. 27430, date 21.03.2002 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "Millenium Construction" shpk, me seli ne Tirane. Me Vendimin Nr. 27430/1, date 03.03.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Shoqeria ka pesuar ndryshime dhe aktualisht ajo perbehet nga nga tre ortak , nga David Lleshi ,qe zoteron 50 % te kuotave , te barabarta me 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise , nga Ardita Prendi qe zoteron 25 % te kuotave , te barabarta me 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise dhe nga Ndrek Lleshi, qe zoteron 25 % te kuotave, te barabarta me 25 % te Kapitalit themeltar te kesaj Shoqerie .

2.OBJEKTI I KONTRATES :

1. Me vullnet te lire e te plote te paleve dhe ne perputhje me Vendimin Nr. 5, date 26 Shkurt 2007 te Asamblese se Jashtezakoneshme te Ortakeve te Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "Millenium Construction" Sh.p.k , Znj. Ardita Prendi i shet teresisht te 25 % (njetzet e pese perqind) kuotat qe ajo zoteron ne kete Shoqeri, zotit Ndrek Lleshi .-

2. Z. Ndrek Lleshi deklaroi se eshte dakort te bleje teresisht 25 % te kuotave ne Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "Millenium Construction" Sh.p.k, te zoteruara nga Znj.Ardita Prendi ne perputhje me Vendimin Nr.5,date 26.02.2007 te



Asamblese te Jashtezakoneshme te kesaj shoqerie dhe ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete kontrate.

3. ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES:

1. Palet deklarojne se kane rene dakort ndermjet tyre qe vlera e shit-blerjes te kuotave te mesiperme eshte 25.000 (njetzet e pese mije) Leke , per te cilat Znj.Ardita Prendi deklaroi se i ka marre teresisht nga Bleresi perpara redaktimit te kesaj kontrate, jashte Zyres noteriale.

2. Z. Ndrek Lleshi deklaroi perpara meje Noterit se i ka paguar zonjes Ardita Prendi teresisht vleren e blerjes te kuotave te saj , qe zene 25.000 (njetzet e pese mije) Leke, perpara redaktimit te kesaj kontrate, jashte Zyres noteriale.

3. Shitesia garanton Bleresin se kuotat, objekt i kesaj kontrate, jane plotesisht te disponueshme , te transferueshme dhe te lira nga çdo lloji pengu, hipoteke apo barre tjeter ligjore .

4. Pas nenshkrimit perpara Noterit te kontrates se mesiperme, Znj. Ardita Prendi zhvishet teresisht nga pronesia mbi 25 % te kuotave ne Shoqerine Tregtare "Millenium Construction" Sh.p.k,qe zene 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise dhe pronar i tyre i ligjshem behet Z. Ndrek Preng Lleshi .

5. Pas blerjes te kuotave te mesiperme, Z. Ndrek Lleshi behet pronar i 50 % (pesedhjet perqind) te kuotave te Shoqerise Tregtare "Millenium Construction" Sh.p.k, qe perbejne 50 % (pesedhjet perqind) kapitalit themeltar te saj .

4. VLEFSHMERIA E KONTRATES:

1.Kontrata eshte e vlefshme ligjerisht menjehere me nenshkrimin e paleve perpara noterit dhe vertetimit nga ana e tij e kontrates.....

2.Palet detyrohen te respektojne kushtet e kesaj kontrate.Çdo mosmarveshje zgjidhet ne mirekuptim,e nese nuk arrihet zgjidhje palet mund t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per zgjidhje gjyqesisht.....

Kjo kontrate Shitblerje u redaktua ne kater kopje origjinale, me vlere te njeje ligjore, konform nenit 705 e vijues te K.C. te Republikes se Shqiperise,e cila u lexua nga palet dhe ata deklaruan se jane dakort me permbajtjen e saj dhe e nenshkruan pa vrejte, ndersa une noteri ,e legalizova -

PALET KONTRAKTORE

SHITESIA

Ardita Prendi
[Signature]



BLERESI

Ndrek Lleshi
[Signature]

